



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMLJENO DANAL		26.05.2026	
KUCCIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LINDËS BR. PREDMETI	SHTOJCA PRIOLOG
08-080/01-23664			



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## KOMISIONI VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK - KONJUH

Në mbështetje të nenit 17 dhe 19 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Gazeta zyrtare 2019/10 data 03.04.2019, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës Nr-15-462/01-4912, të dates 28.01.2025, Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh të Komunës së Lipjanit, i formuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.15-020/04-13700, të dates 24.03.2026, shpallë këtë:

### NJOFTIM

#### PËR ANULIMIN E NJOFTIMIT PUBLIK Nr. NR. 01-462/01-23647 TË DATES 12.05.2025 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

I. NJOFTOHEN të gjithë aplikuesit për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale me nr. të parcelës P-71409036-00166-7 dhe P-71409036-00164-20 ZK – Konjuh, se procesi i vlerësimit të ofertave sipas Njoftimit publik Nr. Nr. 01-462/01-23647 të dates 12.05.2025 ANULOHET për shkak të ndryshimit të rrethanave pas pezullimit të këtij procesi.

II. Puna e Komisionit sipas Njoftimit publik me Nr. 01-462/01-23647 të dates 12.05.2025 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për ZK – Konjuh përfundon, prandaj edhe anulohen të gjitha veprimet juridike të ndërmarra përkitazi me këtë Njoftim publik.

III. Ky Njoftim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni Vlerësues.

### Arsyetim

Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës P-71409036-00166-7 dhe P-71409036-00164-20 ZK – Konjuh, i themeluar me Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.15-020/04-13700 të datës 24.03.2026, gjatë punës së tij ka analizuar të gjitha rrethanat e krijuara pas pezullimit të procesit dhe me këtë rast ka kostatuar se:

1. Ky proces ka filluar në bazë të Njoftimit publik që nga data 12.05.2025 dhe është ndërprerë/pezulluar në fillim të muajit qershor 2025 në bazë të nenit 10 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës. Në bazë të kësaj dispozite, pezullimi i procesit ishte i domosdoshëm për shkak të shpalljes së zgjedhjeve lokale.

*[Handwritten signatures]*

2. Në ndërkohë, përbërja e Komisionit ka ndryshuar si rezultat i ndryshimit të përbërjes së anëtarëve të Kuvendit Komunal, ku dy anëtarë caktohen nga radhët e tyre. Dy anëtarët e mëparshëm të Komisionit nga radhët e asambleistëve nuk janë më anëtarë të Kuvendit, rrjedhimisht ata nuk mund të jenë as anëtar të Komisionit. Prandaj, konsiderojmë se ky proces nuk e ka rrjedhshmërinë e vazhdueshme që nga fillimi. Komisioni nuk e ka përcjellur drejtpërdrejt të gjithë procesin dhe nuk ka pasur vazhdimësi procedurale dhe administrative. Këto fakte mund ta sjellin në dyshim objektivitetin dhe integritetin e vlerësimit.

3. Për shkak të rrethanave të përshkruara si më lartë, vazhdimi i procesit për vlerësimin e ofertave po bëhet pas një (1) viti prej pezullimit të tij. Për shkak të ndryshimit substancial të rrethanave ekonomike, përfshirë rritjen e ndjeshme të çmimeve dhe vlerës së pronave në treg, atëherë vazhdimi i procedurës me kushtet fillestare do të jetë në kundërshtim me parimin e ekonomicitetit, mbrojtjes së interesit publik, menaxhimit të mirë të pronës komunale, proporcionalitetit dhe ligjshmërisë administrative.

4. Disa nga dëshmitë e dorëzuara nga ofertuesit, të cilat kanë qenë të lidhura me pasqyrimin e gjendjes në kohë, tani më nuk e arrijnë efektin e tillë. Në mesin e këtyre dokumenteve janë ato që janë të përcaktuara me pikën 4, 5, 6, 7 dhe 8 të Njoftimit publik -pjesa III "Dokumentet e kërkuara".

5. Dëshmitë sipas pikës më lartë (pika 4), nuk ofrojnë siguri juridike për vlerësim adekuat, objektiv dhe konform rrethanave të reja ekonomike, përkatësisht nuk janë të përputhshme me kriteret e përcaktuara për vlerësim sipas pikes V. (kriteret për zgjedhjen e ofertave) të Njoftimit publik Nr. 01-462/01-23647 të datës 12.05.2025.

6. Ndryshimi i rrethanave ekonomike që një vit nga periudha kur janë pranuar ofertat, e sjellë në mospërputhje vlerën investive të ofertuesve me rrethanat aktuale për realizimin e projekteve. Në këtë rast krijohet pasiguri juridike në vlerësimin e ofertave lidhur me këtë kriter, rrjedhimisht edhe të mbrojtjes së interesit ekonomik të komunës për dhënien në shfrytëzim të pronave të caktuara.

Palët e pakënaqura nga procesi i shqyrtimit të ofertave nga Komisioni, prej ditës së pranimit të Njoftimit, bazuar në nenin 20 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë brenda afatit prej shtatë (7) ditëve kalendarike në Komisionin e ankesave.

Ky Njoftim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komunës dhe me të njejtin njoftohen ofertuesit të cilët kanë parashtruar ofertat në bazë të Njoftimit publik Nr. 01-462/01-23647 të datës 12.05.2025.

Datë: 25.05.2026

1. Latif Ramadani

2. Imri Semetishti

3. Venhar Agushi

4. Besim Jusufi

5. Bekim Krasniqi